



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË  
GRAMSH

Nr. 158/prot  
12

Gramsh, më 01/01/2022

**VENDIM**  
Nr.135, datë, 29.12.2021

**“Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë”**

Këshilli i bashkisë Gramsh, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga drejtoria e shërbimeve me sipërmarrje, transportit, strehimit dhe emergjencave civile, “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë”, bazuar në ligjin nr.22/2018, “Për strehimin social”, neni 38, neni 73, pika 2, gërma v, Vkm-së Nr.362, atë 29.05\2019” Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lire, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij” Vkm-së r.459, date 3.7.2019 “Për rregullat për administrimit e kërkesave të njësisve të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit ,mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin” dhe ,të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8;

**Vendosi:**


- I. Miratimin e nivelit të qirasë mesatare mujore në treg të lire sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Gramsh, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Cmimi mesatar
1	Banese me qira (Apartament tip garsoniere)	muaj	1	6000
2	Banese me qira (Apartament 1+1)	muaj	1	7800
3	Banese me qira (Apartament 2+1)	muaj	1	11000
4	Banese me qira (Apartament 3+1)	muaj	1	10000

- II. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë është e barasvlefshme me qirate mesatare në tregun e lire sipas vlerave të paraqitura në këtë projekt vendim.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Shërbimeve me Sipërmarrje, Transportit, Strehimit dhe Emergjencave Civile.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë  
Xhulia Gjini

Konc.Xh.Gjini  
Konf.G.Lena  
Dosja \_\_\_\_\_  
Afati i ruajtjes \_\_\_\_\_



Kryetari i Këshillit të Bashkisë  
Greta LENA

